

SPECIFIKIME TEKNIKE

Ndryshimet e paparashikuara në kuader të projektit të miratuar me
Vendim KKTKM, Nr.58, datë 12.02.2021 "Revitalizimi dhe
Rekualifikimi i Territorit të Ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", Parku
i Artit"

PRILL 2022

Contents

1.	SEKSIONI - SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME	2
1.1	Të përgjithshme.....	2
1.1.1	Shpjegim i terminologjisë.....	2
1.1.2	Ndërhyrjet në “monumentet e kulturës”	2
1.1.3	Qëllimi i punës	2
1.2	Mbrojtja.....	3
1.2.1	Puna ekzistuese:	3
1.2.2	Zbritja e Materialeve:	3
1.2.3	Dëmtimet gjatë Dimrit:	3
1.3	Skeleria: 2.431 - Skele metalike me tubo fasade, 2.439 - Panele metalike për skelë 3	
1.4	Transporti, hedhja dhe magazinimi i materialeve (2.37/5b).....	4
1.5	Pastrimi i kantierit	4
2.	SEKSIONI - PUNIME PRISHJE/ÇMONTIMI.....	5
2.1	Të përgjithshme.....	5
2.2	Punime prishjeje.....	5
2.2.1	Çmontim çatie (R.199) – mbulesa ekzistuese me tjegulla marseglieze, zbritje, sistemim.....	5
2.2.2	Prishje suvatimi (R.121).....	6
2.2.3	Çmontim kaseta shkarkimi dhe ullukë (An, R. 239).....	6
2.2.4	Çmontim konstruksion metalike, sistemim,transport (R.217).....	Error!
	Bookmark not defined.	
3.	SEKSIONI 3. NDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE.....	6
3.1	Specifikimet e ndërhyrjeve restauruese – në çati	6
3.1.1	Montim kaseta shkarkimi - Ullukët (An, 2/209).....	6
3.1.2	Pastrim i sipërfaqeve / soletës së çatisë nga pluhurat depozitimet (An).....	7
3.1.3	Restuarimi i çatisë në pjesën ku struktura është me panele betoni të lehtësuar mbulim me tjegulla marseglieze:	8
3.1.4	Rikonstruksioni i çatisë në pjesën ku struktura është me strukturë druri dhe mbulim me tjegulla marseglieze:	10
3.2	Specifikimet e ndërhyrjeve restauruese – në fasadë / kulla.....	12
3.2.1	Restaurim kornize e kullës/oxhakut (R.228).....	12
3.2.2	Suvatim Fasade (2.334).....	12
3.2.3	Lyerje, bojë hidroplastike cilësi e I-rë (2.404/1).....	12

1. SEKSIONI - SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Të përgjithshme

Çdo ndërhyrje në pasurinë kulturore duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKTKM, këto specifikime teknike, si dhe normat teknike të restaurimit.

Baza ligjore shqiptare e aplikuar në pasuritë kulturore materiale gjatë procesit të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse:

- Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- VKM Nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”.
- VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit”.

1.1.1 Shpjegim i terminologjisë

“Monument kulture i kategorisë II”: është ndërtimi me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme.

“Restaurim”: është vlerësimi i thelbit origjinal të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. Në rastin e vlerave të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, që gjenden në zona të deklaruara me rrezik sizmik, sipas ligjeve në fuqi, restaurimi përfshin edhe ndërhyrjet për përmirësim strukturor.

Këshillat mbi Parimet dhe Metodat të cilat ofrojnë udhëzimet e propozuara të ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese duhet të lexohen së bashku me këtë dokument.

1.1.2 Ndërhyrjet në “monumentet e kulturës”

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Teknika dhe materiale me karakter reversibël edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

1.1.3 Qëllimi i punës

Kontraktori duhet të bëjë kujdes në zbatimin e punimeve sipas projektit të miratuar në KKTKM në përputhje dhe me kushtet e kontratës, si dhe të plotësojë çdo difekt gjatë punimeve. Kontraktuesi do të sigurojë që drejtuesi teknik i punimeve restauruese të jetë prezent gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve, gjithashtu personeli i kualifikuar për këto tipologji punimesh. Materialet, pajisjet dhe të gjitha sende të tjera, qoftë të një natyre të përkohshme ose të përhershme, të nevojshme për zbatimin dhe përfundimin e punëve, dhe për korrigjimin e ndonjë defekti, për aq sa është e specifikuar në këtë dokument, ose

mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës nga Drejtuesi i Projektit më tej i quajtur Mbikqyrësi i Punimeve restauruese.

1.2 Mbrojtja

1.2.1 Puna ekzistuese:

Para fillimit të punëve Kontraktuesi së bashku me Mbikqyrësin duhet të inspektojnë dhe të identifikojnë të gjitha njësitë ekzistuese të cilat do të mbahen ose të ripërdoren. Një punë e tillë ekzistuese e cila është: (a) të mbeten në vend, (b), për ripërdorim, ose (c) të mbetet pronë e MK, do të mbrohet duke përdorur mbulesa të përkohshme, perforcuese dhe parandaluese. Objektet të cilat do mbeten dhe të cilat janë të dëmtuara gjatë kryerjes së punës do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e Kontraktuesit. Nuk duhet të mbingarkohen elementet strukturore me depozitime materiale. Duhet siguar mbështetje të reja dhe përf forcime për ndërtimet e dobësuar ekzistuese nga punimet e prishjeve-çmontimeve. **Në asnjë moment për çfarëdolloj arsye nuk duhet të rrezikohet dëmtimi i strukturës së pasurisë kulturore.** Nëse vihet re humbja e stabilitetit të strukturës atëherë Kontraktuesi do të marrë masa të menjëhershme për të siguruar punimet (puntelime, përf forcime, pajantime) dhe të izolojë zonën dhe të informojë Mbikqyrësin.

1.2.2 Zbritja e Materialeve:

Kur materialet ose mbeturinat zbriten nga lartësitë, kujdes duhet të merret për të parandaluar lëvizjet e materialeve, rënien në mënyrë të tillë që ajo krijon një rrezik për sigurinë e personelit ose të pronës publike të çdo lloji.

1.2.3 Dëmtimet gjatë Dimrit:

Pasuria kulturore duhet të jetë e mbrojtur nga dëmet e mundshme që vijnë si pasojë e temperaturave të ulëta. Do ishte e preferuar që të evitohet puna në temperatura më të ulëta se 5° C, por në rast se do jetë e domosdoshme të vijojë puna pa ndërpreje të merren masa shtesë për të siguruar mikroklimë me temperatura të përshtatshme për punimet si fugatime, injektme, qepje konstruksioni apo punime të cilat ndikohen drejtpërsëdrejti nga temperaturat dhe ciklet ngrirje-shkrirje.

1.3 Skleria: 2.431 - Skele metalike me tubo fasade, 2.439 - Panele metalike për skelë

Të gjitha skelat duhet të projektohen dhe të montohen në përputhje me standardet e kërkuara. Vetëm punëtorët me përvojë dhe kompetent do të montojnë skelerinë në lartësi. Kontraktuesi do të sigurojë që çdo modifikim të nevojshëm të skelave gjatë rrjedhës së punëve, do të pranohen nga montuesit e skelave në mënyrë që skela do të mbetet e përshtatshme për qëllimin për të cilin janë të dedikuara. Nënshkrimi i miratimit të skelës do të bëhen i dukshëm në çdo pikë të hyrjes në nivel të tokës tek skela. Punimet në skelë të paautorizuara janë rreptësisht të ndaluara. Duhet patur kujdes që ngarkesa e çdo grumbulli mbeturinash në skelë nuk e duhet ta kalojë

ngarkesën e lejuar sipas projektimit dhe të bëhet shpërndarje e tyre. Ngarkesat maksimale të lejueshme të skelave do të jenë qartë të dukshme në të gjitha pikat e hyrjes në nivelin e tokës. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hedhjen aksidentalisht të mbeturinave nga platforma.

Skela metalike e tipit mbështetës, në përputhje me standardet dhe rregullat lokale, duke përfshirë furnizimin e mbështetëses, mirëmbajtjen, montim, ankorimit, çmontimin etj 15cm nga dyshemeja do të vendosen në të gjitha nivelet. Copë mbrojtëse ndaj motit ose të paktën rrjetë mbrojtëse duhet të vendoset në pjesën e jashtme të skelës. (sipas preventivit, ky çmim është për njësi Lekë/m²):

1.4 Transporti, hedhja dhe magazinimi i materialeve (2.37/5b)

Duke përjashtuar rastet ku tregohet në specifikime, në raste të tjera të gjitha materialet rikupero do të ripërdoren dhe materialet e papërshtatshme largohen nga kantieri dhe nuk ripërdoren. Titullimi për të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja - çmontimi, dhe pajisjeve që do të hiqen, i vishet Kontraktuesi me miratimin e Mbikqyrësit. Me autorizim nga Mbikqyrësi mund të fillojnë punimet për prishjen - çmontimin. Materialet dhe pajisjet rikupero të pronës nuk do të shiten nga Kontraktori, ato mund të ripërdoren sipas udhëzimeve të mbikqyrësit ose të bëhen pronë e Ministrisë së Kulturës si institucioni administrues i kësaj pasurie kulturore.

Materialet e tjera që nuk mund të ripërdoren dhe që konsiderohen si mbetje, do të largohen nga Kontraktori dhe do të depozitohen në vendet e caktuara nga Bashkia. Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

Në çmim përfshihet transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia me auto deri në 10 km. Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

1.5 Pastrimi i kantierit

Kontraktori duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

2. SEKSIONI - PUNIME PRISHJE/ÇMONTIMI

2.1 Të përgjithshme

Punimet e prishjes dhe çmontimit në restaurim janë një proces i rëndësishëm. Në të duhet të marrin pjesë punëtorë të specializuar të cilët duhet të mbikëqyren në çdo rast nga drejtuesi teknik i punimeve restauruese. Nëpërmjet prishjes evidentohen gjurmë të cilat sjellin dëshmi të reja lidhur me monumentin të cilat duhet të dokumentohen.

KËRKESAT: Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktuar ose të specifikuar. Punimet e prishjeve nuk do të fillojnë deri sa autorizimi të merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit të ndërtimit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marrë masat e duhura për sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjëherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asgjësimin e duhur të mbetjeve.

Mbikqyrja: Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe punimeve të çmontimit në kantier.

2.2 Punime prishjeje

2.2.1 Çmontim çatie (R.199) – mbulesa ekzistuese me tjegulla marseglieze, zbritje, sistemim

Gjatë punimeve të çatisë – mbulesës Kontraktuesi do të sigurojë mbulimin e strukturës dhe marrjen e masave gjatë çmontimit të strukturës së vjetër të mos kemi dëmtim të ambjentëve të brendshme të cilat kanë përfunduar punimet. Gjithashtu nga Kontraktori të sigurohet material për mbulim të përkohshëm të tilla si copa për mbrojtjen ndaj motit. Në përgjithësi heqja e mbulim duhet të bëhet në koordinim me fazat e punimeve të çatisë në mënyrë që kërkesa e mbulimit të përkohshëm të jetë në minimum.

Përpara fillimit të punimeve të restaurimit, kryhen punimet e çmontimit të elementëve të mbulesës. Puna do të fillojë me heqjen e kujdesshme e tjegullave marseglieze, e më pas gjithë strukturës së çatisë, trarë / binarë tek pjesa me konstruksion druri dhe pastrim i sipërfaqeve tek pjesa me panele betoni etj. Materialet do të zbriten dhe sistemohen si dhe do të vlerësohen nga Mbikqyrësi nëse janë në gjendje për tu ripërdorur (do t'u nënshtrohen përkujdesjeve konservuese për tu ripërdorur nëse do jetë e nevojshme, por pritshmëria është që këto tjegulla nuk janë më në standart për tu ripërdorur pasi tjegullat marseglieze kpen me kllapa të cilat me kalimin e kohës dëmtohen dhe praktika ka treguar që rikupero në këto lloj tjegullash është minimale), më pas të gjitha materialet e panevojshme do të largohen nga kantieri.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për zbulimin. Mbasi bëhen këto punime paraprake, në prezencë të kontraktorit, dhe mbikëqyrësit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë që do të përdoret brenda kushteve teknike dhe për pjesën e dëmtuar që do të hidhet. Në çmim përfshihet dhe zbritja, sistemimi i tjegullave dhe shkarkimi në vendet e përcaktuara nga Bashkia. Ky çmim është për njësi Lekë/ m² çati në plan.

2.2.2 Prishje suvatimi (R.121)

Fillimisht të jetë stakuar energjia elektrike. Sipërfaqet e suvasë fillimisht do provohen me trokitje nëse kemi zona boshe dhe shkëputje të saj. Prishja e suvasë së dëmtuar do bëhet me shumë kujdes në mënyrë që të mos humbasim ndonjë gjurmë të mundshme që mund të fshihet poshtë saj. Shkalla e dëmtimit të suvasë do të gjykohet në vend sipas nevojave të objektit.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për prishjen e suvatimit të dëmtuar tek kulla/oxhaku dhe faqja e fasadës ndërmjet kullës dhe objektit (pas cmontimit të strukturës metalike). Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.2.3 Çmontim kaseta shkarkimi dhe ullukë (An, R. 239)

Çmontimi i kasetave të shkarkimit dhe ullukëve vertikalë e horizontalë, do të kryhet para çmontimit të çatisë në mënyrë që të mos të dëmtohen dhe të montohen sërish në fund të punës. Ato do të depozitohen në kantier në mënyrë të sigurtë.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për cmontimin dhe sistemin në vend depozitim të kasetave dhe ullukëve. Ky çmim është për njësi Lekë/copë kasetat dhe Lekë/ml ullukët.

3. SEKSIONI 3. NDËRHJRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

3.1 Specifikimet e ndërhyrjeve restauruese – në çati

3.1.1 Montim kaseta shkarkimi - Ullukët (An, 2/209)

Montimi i kasetave të shkarkimit dhe ullukëve vertikalë e horizontalë, do të kryhet në fund të punës pasi të restaurohet e gjithë çatija.

Do të vendosen ullukët vertikal e horizontal që u cmontuan më herët. *Ulluket horizontale*, realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujërave, me mbivendosje minimale 5cm, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, duhet të jetë i fiksuar me fashetë, me hallka të forta të vëna maksimumi në 70cm.



Ulluqet vertikale të fiksohen me anë të qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuar çdo 2 m.

Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të. Ky çmim është për njësi Lekë/copë kasetat dhe Lekë/ml ullukët.

3.1.2 Pastrim i sipërfaqeve / soletës së çatisë nga pluhurat depozitimet (An)

Pasi të kryhen punimet e çmontimit të tjegullave. Puna do të fillojë me heqjen e kujdesshme e tjegullave marseglieze, e më pas gjithë strukturës së çatisë, trarë / binarë tek pjesa me konstruksion druri dhe pastrim i sipërfaqeve tek pjesa me panele betoni në skaje etj. Pastrimi nga depozitimet e dherave apo dhe copëzat e llaçit ose gurëve përfshin pastrim manual me furçë teli dhe shplarje me ujë të bollshëm për ta përgatitur atë për shtresën niveluese. Ky proces përcaktohet në vend gjatë fazës së parë të zbatimit të punimeve nën drejtimin e Mbikqyrësit të punimeve restauruese.




Fig. Shembull korpusi kryesor MK

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin e sipërfaqes. Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

3.1.3 Restuarimi i çatisë në pjesën ku struktura është me panele betoni të lehtësuara mbulim me tjegulla marseglieze:

Gjate hapjes së çatisë, mund të dalin situata të reja të paparashikuara sidomos në pjesët e takuese të intersektimit dhe në pjesët e këndeve të çatisë. Mbasi të hapet çatia do të bëhet konsulta në vend me Mbikqyrësin e punimeve për llojin e ndërhyrjes të parashikuar sipas dy rasteve të shpjeguara mbi soletë dhe mbi konstruksion druri. Mbulesa e çatisë do të jete me tjegulla marseglieze. Çatia do të nenshtrohen shtresave të hidroizolimit dhe termoizolimit. Ndertesa do të pajiset me ulluk horizontal dhe vertikal prej bakri të cilat do të cmontohen dhe rimontohen sërrishtë si dhe pusetat shkarkuese të cilat janë realizuar në Lotin I.

Restaurimi i çatisë në këtë pjesë përbëhet nga një sërë punimesh të shpjeguara dhe grafikisht në detaj:



Struktura e çatisë së ndërtesës është realizuar me konstruksion panele betoni të mbështetura në trarë betoni dhe kapriata metalike, mbuluar me tjegulla marseglieze. Përfshihet tërësia e punimeve që duhet të kryhen për restaurimin e çatisë në:

- Pas pastrimit të sipërfaqes do të vijohet me nivelim me shtresë prej llustërimento 1:2, t = 20 mm.

Shënim: Ky është një proces shumë i rëndësishëm në të cilin do të bëhet kujdes i veçantë gjatë fazës së zbatimit të punimeve në praninë e mbikqyrësit të punimeve për nivelimin e saktë të sipërfaqes.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për nivelimin e sipërfaqes. Në çmim përfshihet edhe transporti i materialeve dhe ngarkim shkarkimi i tyre. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

- Hidroizolim me dy shtresa llaci me baze cemento, përgatitur nga dy komponente A+B ose me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama

Shënim: Përzgjedhja e shtresës hidroizoluese do të vendoset në vend nga mbikqyrësi në varësi të situatës që do të rezultojë pas hapjes së strukturës dhe nivelimit të saj. Është menduar që të jetë me shtresë bi komponent mapej mbi strukturën e paneleve dhe katrama mbi strukturën e konstruksionit të drurit. Hidroizilimi i paneleve të betonit me 2 shtresa hidro izoluese, bwhtet mbi sipërfaqe të tharë dhe të niveluar mirë.

Ky është një proces në të cilin do të bëhet kujdes i veçantë gjatë fazës së zbatimit të punimeve në praninë e mbikqyrësit të punimeve dhe përzgjedhja e teknikës së hidroizolimit do të realizohet pas konstatimit të situatës.



Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për përfundimin e punës. Në çmim përfshihet edhe transporti i materialeve dhe ngarkim shkarkimi i tyre. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

- Termoizolim me polisterol 5m dendësi max

Shënim: Përzgjedhja e shtresës termoizoluese do të vendoset nga mbikqyrësi, ajo duhet të sigurojë dendësi maksimale dhe cilësi dhe standart optimal.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për përfundimin e punës. Në çmim përfshihet edhe transporti i materialeve dhe ngarkim shkarkimi i tyre. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

- Mbulesë çatie me tjegulla marselieze përfshirë binarët e drurit




Vendosja e tjegullave marseglieze të ngjashme me ato që janë vendosur në pjesën tjetër të ndërtesës duke përdorur tjegulla të cilat nuk janë të thyera dhe të përshkueshme nga uji..

Tjegullat do vendosen në rrjeshta të drejtë me plumbce dhe mbi listela druri sic tregohet dhe në foto.

Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të. Kjo jepet për 1 m² çati të përfunduar në plan

3.1.4 Rikonstruksioni i çatisë në pjesën ku struktura është me strukturë druri dhe mbulim me tjegulla marseglieze:

Restaurimi i çatisë në këtë pjesë përbëhet nga një sërë punimesh të shpjeguara dhe grafikisht në detaj:



Çatia e ndërtesës është realizuar në pikat e takimit dhe në kënde me konstrukcion druri, mbuluar me tjegulla marsejeze dhe ka pika bashkimi me soletat e betonit si në foto.



Në këto pjesë ashtu edhe nëpër këndet fundore të çatisë nivelimi do të kryhet me strukturë konstrukcion druri dhe do të nivelohet me pjesën tjetër të strukturës.

Përfshihet tërësia e punimeve që duhet të kryhen për restaurimin/rikonstrukcionin e çatisë në konstrukcionin e saj, me lëndë të sharruar dhe mbulesa me petavra druri, lëndë hidroizoluese, termoizolim, listela për mbështetjen e tjegullave marsejeze.

Duhet patur parasysh, që të largohen të gjitha elementet mbajtëse, që janë të dëmtuara ose të kalbura dhe të zëvendësohen ato me të reja, të cilat t'i plotësojnë KTZ dhe kërkesat e projektit. Përpara se të fillojë puna për vendosjen e tjegullave, duhet që të bëhet një kontroll i imtësishëm për gjendjen e elementeve mbajtës dhe vetëm pasi të sigurohemi që elementët konstruktiv janë në gjendje të mirë mund të vazhdojë puna.

Restaurimi do të fillojë me:

- Përshtatjen e konstrukcionit të drurit të çatisë sipas skicave teknike.
- Lyerja e konstrukcionit të ri të drurit të rivendosur me solucion antimol dhe vaj lini.
- Ndërtimi i shtresës së drurit të petavra.
- Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama
- Aksesore/profil metalik për pika e lidhjes së çatisë
- Impluve llamarine në pikat e intersektimeve
- Tavan kartonxhes poshtë strukturës së çatisë me konstrukcion druri
- Vendosja e tjegullave të cilat nuk duhet të jenë të thyera dhe të përshkueshme nga uji.

Të gjitha materialet që do të përdoren do të jenë të pajisura me çertifikatë cilësie. Lënda e drurit e cila do të përdoret do të jetë dru pishe e stazhionuar mirë dhe e cilësisë së lartë, me karakteristika:

Lagështi jo më tepër se 12 %,
Peshë volumore 410 – 540 Kg/m³,
Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa,

Elementët drusorë do të nënshtrohen një trajtimi dizinfektues ndaj agentëve atmosferikë dhe krimbave e kërpudhave me antimol e insekticid. Trarët në pjesën mbështetëse të murit do të lyhen me zift ose material kundër lagështirës, në të gjitha rastet trarët ndërmjet tyre, do të kapen me ganxha metalike.

Ndërtimi i shtresës së drurit të petavra 2.5 * 15÷20 cm. Dyshemeja me petavra pas përfundimit do të trajtohet me solucion antimol, anti lagështirë, insekticid dhe në fund do të lyhet me 2 duar vaj lini.

Shtrim i fletës hidroizoluese 4mm. Kujdes i veçantë duhet të merret në përgatitjen e sipërfaqeve të papërshkueshme nga uji; ndonjë pikë e mundëshme e hapur duhet të mbyllet me silikon dhe të stukohet. Hidroizilimi duke realizuar mbivendosjen e shtresave (minimumi prej 12 cm).

Në çmim përfshihet rikonstrukcioni total i çatisë ku do të merret parasysh zëvendësimi i të gjitha elementëve të saj si, trarët mbajtës, mahitë, petavrat, lyerjet dhe trajtimin i lëndës drusore me vaj lini, listela për mbështetjen e tjegullave marseglieze. Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të. Kjo jepet për 1 m² çati të përfunduar në plan.

3.2 Specifikimet e ndërhyrjeve restauruese – në fasadë / kulla

3.2.1 Restaurim kornize e kullës/oxhakut (R.228)

Korniza do të pastrohet fillimisht me ujë të bollshëm, do kontrolohen pjesët e dëmtuara dhe do të plotësohet me të njëjtin profil dhe material pjesa e dëmtuar. Korniza do të jetë e vazhduar. Nëse e nevojshme lidhja e pjesës së plotësuar dhe kornizës origjinale do të realizohet me shufra hekuri për kosistencë më të mirë.

Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të. Kjo jepet për 1 ml kornizë të përfunduar.

3.2.2 Suvatim Fasade (2.334)

Suva e zakonshme fasadë mur tulle h ~ 8 m tek kulla dhe faqja e fasadës ndërmjet kullës dhe objektit (pas cmontimit të strukturës metalike).

Sipërfaqja e suvatuar do të kontrollohet e gjitha duke evidentuar suvatimin e shkëputur, i cili do të priset deri në tullë. Do të evidentohen çarjet nëse ka. Fasadat do të lahen me ujë të bollshëm duke pastruar sipërfaqen nga pluhurat. Fillimisht do të kryhen stukimet, qepjet e çarjeve të mundshme dhe sistemimi i sipërfaqeve ku është i nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç gëlqere 1:3, me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Llaci i suvasë nuk duhet të aplikohet në $t_m \leq 5^\circ\text{C}$.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi gëlqere i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15cm çdo 1 deri në 1,5m), dhe e lëmuar me mistri e përdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin. Rëra për suva duhet të jetë e përbërë nga kokriza të dimensioneve të tilla për të kaluar në sitë me përmasa 1mm.

Në këtë zë punimesh përfshihen çmimet që duhen për të realizuar sipas kushteve teknike riparimet e suvatimeve të mureve të tullës, përgatitja e sipërfaqes së murit pastrimi nga pluhuri, lagia, hedhja e sprucos deri në tharje, dora e dytë, dhe finoja, skelerit e nevojshme, për 1 m². Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme me cilësi, transporti i tyre, përpunimi dhe vendosja në objekt. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

3.2.3 Lyerje, bojë hidroplastike cilësi e I-rë (2.404/1)

Proçesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve kalon nëpër tre faza si më poshtë:

Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet:

Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e sipërfaqes së mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit dhe bërja gati për paralyerje. Përpara fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Paralyerja e sipërfaqes së pastruar:

Në fillim të procesit të lyerjes, bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqeren të holluar (Astari). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg hidromat me një litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër hidromat e holluar duhet të përdoret për 4 m² sipërfaqe.

Lyerja e sipërfaqes me hidromat cilësi e parë duke unifikuar ngjyrën e fasadës në total.

Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme me cilësi, transporti i tyre , përpunimi dhe vendosja në objekt. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².